

DISKUTIM PUBLIK- PLANI RREGULLUES I HOLLËSISHËM "KALABRIA"

DAT\Ë: 22.05.2022

ORA:10:00

VENDI: SHF "7 MARS", LAGJA "KALABRIA", PRISHTINË

PERMBAJTJA :

1. REGJISTRIMI I PJESËMARRËSVE
2. QELLIMI I TAKIMIT
3. PREZENTIMI I VIZIONIT
4. PREZENTIMI I PROCESIT TË DERITANISHËM
5. PREZENTIMI I OBJEKTIVAVE
6. DISKUTIM ME QYTETARË PËR PLANIN RREGULLUES DHE PROBLEMET QË BALLAFAQOHEN ATA

PJESËMARRËS NË TAKIM :

1. PERPARIM RAMA - kryetar i Komunës,
2. MIMOZA SYLEJMANI - drejtore e Drejtorisë së Planifikimit Strategjik,
3. ARBËR SADIKI - drejtor i Urbanizmit,
4. BANORËT E LAGJES "KALABRIA".

1. REGJISTRIMI I PJESËMARRËSVE:

(të bashkëlidhura i keni listat e nënshkrimeve)

PROCES VERBALI

Përparim Rama, kryetar i Komunës, iu shprehu të pranishmëve mirëseardhje dhe falënderim për pjesëmarrje masive të qytetarëve të lagjes "Kalabria".

Përparim Rama, kryetar i Komunës, theksoi se deri tani kemi pasur plane rregulluese, kemi pasur plane zhvillimore urbane, por tani jemi në proces të hartimit të Planit zhvillimor komunal dhe Hartës zonale.

Si proces i kësaj e kemi pasur një propozimplan për lagjen “Kalabria”, me koeficient të ngritur për gjithë zonën, nga 1.8 në 2.4. Ky propozimplan është shpallur i jashtëligjshëm nga Ministria e Pushtetit Lokal e që ne është dashur të marrim vendimin për shfuqizim, për arsye se ne nuk mund të lejojmë zhvillimin në bazë të një plani që është i jashtëligjshëm. Ideja e koeficientit 2.4 nuk shkakton problem si një figurë e zhvillimit të kryeqytetit, por shkakton problem nëse nuk planifikohet në mënyre të mirëfilltë. Ne duhet të mendojmë edhe për shërbimet e jo vetëm për metrat katrorë. Kjo është edhe ideja e këtij takimi, që ta bëjmë një zhvillim të mirëfilltë e jo një problem shtesë, siç e kemi me disa lagje të tjera. Në lagjen “Kalabria” mund ta bëjmë, e kemi rastin ta bëjmë së bashku. I kemi analizuar në detaje projektpropozimet e deritanishme, e që duhet me u rishikuar, që me e vlerësuar siç duhet këtë vlerë shoqërore. Këtë e mundësojmë duke krijuar hapësira publike me vlerë për te gjitha moshat, shkolla, rrugë, qendra mjekësore, hapësira rekreative, hapësira të gjelbra, që ta zhvillojmë një jetë të mirëfilltë për te gjithë. E kemi filluar procesin e analizës së të gjitha problematikave, edhe qysh me e lidhë lagjen me zonat e tjera, për trafikun urban, për të krijuar mundësi të reja për zonën dhe kryeqytetin. Në këtë propozim kemi ekipet profesioniste të dedikuara për këtë punë, kemi edhe ekspertë të inkuadruar nga jashtë. Për këtë arsye sot kam pasur dëshirë me e bërë një diskutim të përbashkët me ju, me ju dëgjuar nga afër problemet dhe propozimet tuaja, të diskutojmë për çdo gjë që ju pengon apo dëshironi ta keni si pjesë të zhvillimit strategjik të lagjes. I marrim këto informata nga ju, i bëjmë pjese të procesit. Këtu e kemi rastin për ta bërë dhe dua të jem transparent gjatë tërë kohës, për t’ju siguruar që ne jemi këtu për juve e jo kundër juve. Do të bashkëpunojmë për të krijuar një jetesë të mirëfilltë, hapësira të mirëfillta të jetesës, një qytet me vlera shoqërore.

Arbër Sadiki, drejtor i Urbanizmit, u shpreh se për mua është pak më e lehtë me u shprehur këtu, pasi vetë kryetari është i profesionit tim dhe ma lehtëson një pjesë të madhe të të folurit. Dua të them ato çka nuk i tha kryetari, prej pozicionit të drejtorit të Urbanizmit një sqarim të vogël. Drejtoria e Urbanizmit është e detyruar më dhënë leje në baze të planeve të miratuara. Për atë edhe jemi këtu tre personat kyç për këtë punë, Kryetari i Komunës i cili ndërton vizione për qytetin, është Drejtoria e Planifikimit, e cila e harton planin dhe është Drejtoria e Urbanizmit, e cila e implementon planin, kështu që e shoh të rrugës me i thënë disa fjalë për cilësinë e jetës, për çka edhe jemi këtu ne sot. Ne e kemi këtë kualitet të jetës, ju këtu, te tjerët diku tjetër në gjithë Prishtinën, për shkak se është planifikuar në një mënyrë me të cilën ne nuk mund ta pranojmë, që është mënyre pa përfshirje, pa i marrë saktë nevojat e njerëzve, pa kalkulime të sakta. Në këtë rrugë ne bëhemi partnerë me juve për të krijuar cilësi më të mirë të jetës. Planin për të cilin ne kemi ardhur për të biseduar, unë e kam analizuar tash e 4 muaj. Nuk janë shumë, se problematikat në Urbanizëm janë shumë më të mëdha, janë krijuar që 20 e sa vjet edhe ne po tentojmë me i zgjidhur një nga një. Tek lagja e juaj është rast i mirë që me i zgjidh për së mbari. E kam krahasuar shumë detajisht planin ekzistues, i cili ka ekzistuar prej 2006-ës. Plani që ju kanë propozuar juve nuk është plan i 2022-tës, por është plan i 2016-tës. Ky plan ka ardhur i njëjti, pa kurrfarë ndryshimi dhe është propozuar në Kuvend. Ky plan është i pazbatueshëm në shumë drejtime, ndërtesat që janë ndërtuar me leje me planin e 2006-ës, tani janë mbi rrugët e planit te propozuar. Po flasim për një periudhë shumë të gjatë kohore, prej momentit kur është hartuar ky plan dhe ditës që po flasim sot. Andaj jemi të hapur për të kontaktuar me secilin prej jush, që me pasur një gjendje faktike sa më të regjistruar mirë, sepse planifikimi bëhet në bazë të gjendjes faktike dhe kërkesave e vizionit që keni ju për lagjen e tuaj.

Mimoza Sylejmani, drejtore e Drejtorisë së Planifikimit Strategjik, përshëndeti të pranishmit, duke iu dëshiruar mirëseardhje.

Ajo u prezantua para të pranishmëve, duke thënë se unë jam Mimoza Sylejmani, inxhinierë e arkitekturës, tani drejtores e Drejtorisë së Planifikimit Strategjik.

Edhe pse çështjet kryesore u paraqitën nga kryetari dhe drejtori Sadiki, unë do vazhdoj edhe pak.

Ne sot kemi planifikuar me e mbajtur një punëtori me juve, që secili prej jush t'i propozojë idetë dhe kërkesat e veta, por është e pamundshme pasi jeni shumë në numër dhe hapësira është e vogël këtu. Andaj ju kisha lutur që idetë, propozimet dhe kërkesat tuaja të na i thoni sot me gojë, por mund të i dërgoni edhe me shkrim dhe me e-mail. Ne jemi të gatshëm për të bashkëpunuar në çdo lloj forme me juve, tani jemi fiks në kohë për të implementuar në Planin zhvillimor komunal dhe Hartën zonale të cilën jemi njëkohësisht duke e zhvilluar.

Çfarëdo që të keni, ju lutem që për shkak të procesverbalit të prezentoheni dhe të paraqitni shqetësimet dhe kërkesat e juaja.

Ju faleminderit!

Burbuqe - tha se vetë prezenca jonë këtu në këtë masë tregon se sa mbrapa na keni lënë si lagje. Unë dua të di sa është e mundur me u realizuar ky plan, me përqindje dua të di.

Kryetari tha 100%. Unë deri tani ju tregova dhe shpjegova arsyen pse ju kanë lënë kaq mbrapa. Ne jemi duke punuar me seriozitetin dhe angazhimin më të madh për të mirën tuaj së pari dhe të kryeqytetit.

Adem Zeka shprehu mendimin se ne duhet t'i paraqesim kërkesat tona pasi që ta hartoni ju projektin.

Kryetari tha se ne jemi duke e zhvilluar projektin, por ai do të bëhet edhe në bazë të kërkesave tuaja.

A keni pakënaqësi për pjesën ku ju jetoni, p.sh., rrugët, shkolla, ambienti, probleme që ju rrethojnë, që ne t'i marrim parasysh?

Bruno Neziraj u shpreh se unë kam disa ankesa: 1) Ndërrimi i adresave dhe numrave pa nevojë ka shkaktuar probleme; 2) Kubzet e prishura në rrugë, të asfaltohen rrugët dhe të ndërtohen trotualet dhe në disa pjesë të lagjes është e domosdoshme të bëhen rrugët njëkajshe; 3) Të vendosen panelet për mbrojtje (ndalje) të zhurmës; 4) Të shtohen stacione tjera për autobusë, nuk ka mjaftueshëm; 5) Në lagjen tonë ka mungesë të fushave sportive, nuk e kemi as edhe një; 6) Të bëhet zgjidhja e katalizatoreve sa më shpejt; 7) Lidhur me koeficientin, çka do të ndodhë me objektet ekzistuese?

Flutura Kusari, banorë e lagjes, rr. "Shefqet Shkupi" tha se kam pyetje për 2 çështje:

- 1) Kur do të zgjidhet problemi me kolektorët, çfarë masa do të merrni?
- 2) Zhvendosja e laurës (rampës) te Stacioni i Autobusëve, sepse ne si banorë të lagjes sillemi rreth e rrotull për me u lidhur me lagjen "Dardania" p.sh., ose pjesë tjera të qytetit?

Muharrem Hundozi, banor i lagjes, pronar i restorant "Bahçe" dhe 2 pronave që ndodhen në një vijë me kolektorin, paraqiti ankesë është i gatshëm për investim në pronë, por nuk lejohet të ndërtojë.

Kryetari për çështjen e kolektorit tha se veç është përfunduar projekti i rrugës "A", që vjen edhe nga Kalabria, është në proces të prokurimit, brenda 3 muajve vendoset fituesi i kontratës dhe fillimi i punës. 1.2 kilometra është faza e parë, prej rrugës së Veternikut - Kalabria dhe prej Veternikut - Prishtina e Re,

d.mt.th. që e mbyll kolektorin krejt. Edhe për juve pronarëve të tokave, nëse rruga i bie nga toka e juaj, çdo gjë kompensohet në vlerë të ndërtimit.

..... **Banor i lagjes**, problemi i kolektorit vjen nga ndërtimet e Banesave të Arabëve (dëshmi për këtë i dorëzon disa foto nga rr. "Ali Vitia").

Arbër Sadiki tha se do bëj një sqarim të vogël, që ndoshta e minimizon një numër të madh të pyetjeve. Një masë e madhe e problemeve janë se pikërisht me planet ekzistuese, zonat që janë të parapara për interes publik nëpër pronat private, nuk është menduar se si do të kompensohen, kështu që ne nuk duam ta bëjmë të njëjtin gabim në planet e reja.

Sadri Pacolli, banor i lagjes që nga viti 1969. Lagjja ka shumë probleme, por njëri nga to është problemi me ujë. Ne nuk kemi ujë, tash lagjja është e stërngarkuar dhe gypat e vjetër nuk e përballojnë këtë kapacitet. Problem tjetër janë trotuaret, nuk kemi trotuare dhe është rrezik për ne si banorë, sidomos për fëmijë, pastaj mungon ndriçimi nëpër lagje, që po ashtu nuk na jep siguri.

Basri Terrnava tha se ju si Komunë, keni thënë që nuk lëshoni leje dhe vazhdimisht po ndërtohet.

Kryetari u shpreh se çka do që është në plan rregullues ne nuk e kemi ndërprerë.

Lutfi Hoxha shprehu pakënaqësi, duke thënë se na kanë shti me bërë pagesë për legalizimin e shtëpive edhe për planin, edhe na kanë bërë bashkëpronarë pa dëshirën tonë pa na treguar në fillim.

Aziz Jashanica pyeti se plani i ri a do të bëhet në bazë të planit të vjetër, apo do të bëhet komplet plan i ri.

Kryetari tha se gjendja ekzistuese merret si bazë, pastaj koeficientin që e kemi premtuar 2.4, merret si baza tjetër, edhe krijimi i hapësirave, i vlerave, është e treta.

Ismail Rukiqi, banor i lagjes, në rrugën "Apollonia", bëri ankesë lidhur me mungesën e ndriçimit në lagje, për qentë endacakë që janë rrezik i përhershëm, kërkesë që fëmijët të kenë transportin për në shkollë dhe të vendosen numrat nëpër shtëpi, në rrugën "Apollonia" që posta të vije deri në shtëpi.

Albert Fazliu shprehu falënderim për kryetarin dhe stafin e tij që për herë të parë po vijnë në lagje për t'i diskutuar problemet me ta. Kërkesa e tij është që plani të implementohet në favor të qytetareve dhe të kompensohen dinjitetshëm dhe të jetë gjithëpërfshirës.

Besim Jashari, banor i lagjes që nga vitet e 60-ta, pyeti se plani i ardhshëm rregullues sa është analizuar që me u implementuar, që të gjithë banoret të ndahen të kënaqur.

Ahmet Kqiku, banor i lagjes, shprehu falënderim për kryetarin, sepse është hera e parë që po vjen një kryetar dhe po na viziton e po i dëgjon hallet tona. Kërkesa ime është që para se të bëhet Plani rregullues, të na e bëni një trotuar, prej Ambulancës deri te shkolla, se po rrezikohemi çdo ditë.

Adrian Halili pyeti për Kryetarin. Në Planin rregullues a ka ndonjë zgjidhje për zgjerimin e rrugëve, a ka me pas kompensim, p.sh. për banorët që rruga i bie nga prona e tyre, edhe për ata që kanë shtëpi të vogla, por që Plani rregullues kalon nga prona e tyre.

Kryetari tha se kjo është ideja, që në Planin rregullues rrugët me qenë standarde për densitetin që do të krijohet, por sa i përket kompensimit, patjetër që do të kompensohet, çdo gjë kompensohet, sa i përket

asaj pjesës me shtëpitë, atë mund ta diskutojmë së bashku, siç tha edhe zotëria më herët, kur e ndërtojmë rrugën, e rregullojmë ndriçimin, i plotësojmë të gjitha kushtet për jetesë, ajo pjesë edhe mund të mbetet një fshat i bukur me karakter të mire, në vend se me ndërtuar edhe aty ndërtesa.

Enver Osmani, banor i lagjes, rruga “Hazir Shala”, ankese për rrugën e cila është e paasfaltuar, një pjesë e vogël është me kubze dhe kolektori është i ndërtuar në atë rrugë, në vetë është dashtë me bërë qasje me kaluar nëpër të, sepse nuk kemi kah tjetër. Kur bie shi ka vërshime, ju lutem që së paku rrugën ta kryeni dhe të na bëhet një qasje prej rrethrotullimit deri në kolektor, hyrjet-daljet të na rregullohen.

Besian Hoxha, banor i lagjes, bëri kërkesë që të vendosen shportat për mbeturina, të bëhet pastrimi i hapësirave publike dhe mirëmbajtja e gjelbërimit.

Faton Zeka, banor i lagjes, e pyeti kryetarin se a po e vëren sa pakënaqësi ka nga të gjithë në për diskriminimi që na është bërë si lagje. Faleminderit shumë që e keni nisur mirë këtë punë, por desha të di për afatin kohor deri të realizohet plani, për koeficientin veç ke thënë që nuk do të ndryshojë dhe për kompensimin, po shpresoj që do t’i mbani premtimet që na i keni dhënë.

Diana Hoxha – Berisha, banore e lagjes “Kalabria”, me herët thatë se brenda 3 muajve fillon faza e parë e implementimit të kolektorit prej 1.2 km, a do të jetë projekti i njëjte siç është paraparë në pjesën e Matit, ku do të mbetet lumi, edhe në projekt a është paraparë me u zgjeruar edhe rrjeti i Termokosit?

Kryetari tha se sa i përket Termokosit, informatën nuk e kam këtu momentalisht, por e kuptoj prej Termokosit dhe ju lajmëroj, ndërsa sa i përket zhvillimit të rrugës “A”, ideja është që sado që është rrjedhë e ujit natyral e vogël, ajo e krijon një klimë të mirë gjatë verës edhe po tentojmë me e mbajtur, por duhet me u ndarë ujërat e zeza që kanë me hy si pjesë e kolektorit në rrugë.

Suat Haliti, banor i lagjes, paraqiti ankesë për zhurmën e shkaktuar nga muzika nëpër lokale.

Kryetari tha se e kemi bërë publike prokurimin e 1000 matësve të zhurmës, po ashtu kemi iniciuar procesin e marrjes së lejes për muzikë për çdo lokal, edhe kur aplikojnë i vendoset sa decibel janë të lejuar sipas vendndodhjes së lokalit.

Sazane Retkoceri, banore e lagjes, u shpreh se problem është linja e autobusëve që duhet ndërruar, p.sh. unë i ndërroj 2 autobusë, edhe duhet 2 herë me paguar biletë, që për mua si studente është shumë, edhe nëpër stacione ku pritet autobusi nuk ka ulëse.

Kryetari tha se jemi duke punuar që të arrijmë marrëveshje me transportin publik dhe privat, që biletat të vlejnë për 2 linjat, dhe shtimin e 30 autobusëve.

Ragip Aliu, banor i lagjes, tha se banoj në fund të lagjes, përballë tregut, por po më intereson se jam afër kolektorit që është në gjendje të mjerueshme, kundërmon, nuk ka rrugë, nuk ka ndriçim, nuk ka transport, a ka diçka në plan për atë pjesë.

Kryetari tha se në bazë të gjithë planifikimit është edhe ajo pjesë, se qëllimi është që lagja “Kalabria” me qenë gjithëpërfshirëse në plan.

Shyqri Dumani, profesor i mbrojtjes së mjedisit dhe banor i lagjes. Ai tha se shumë gjëra u thanë, të cilat unë nuk do t’i përsëris, por një gjë që më brengos, pse lagja jonë nuk ka asamblist. Unë mendoj që lagja jone duhet të ketë një përfaqësues në Komune, prandaj lagja jone ka probleme të shumta. Planet

urbanistike përpara kanë qenë makaber, qyteti i Prishtinës është shndërruar në një xhungël urbane. Ai luti kryetarin që plani i ardhshëm të jetë në shërbim të qytetarëve e jo në shërbim të mafies ndërtuese.

Sami Berisha, banor i lagjes, tha se idetë dhe vërejtjet e mia do i dërgoj me e-mail. Pyetja ime është se nëse koeficienti 2.4, nuk është pranuar nga pushteti lokal, atëherë pse duhet me insistuar me atë koeficient?

Kryetari theksoi se nuk është koeficienti që s'është pranuar, është procesi qysh ka mbërri deri te koeficienti që nuk është pranuar. Prapë kjo mund të diskutohet edhe më vonë, kështu që nëse ne vendosim me e mbajtur këtë koeficient, duhet të zgjedhim mënyrën më të mirë për me e mbajtur.

Valon Zeka, banor i lagjes, tha se çdo gjë është urgjente në lagjen tonë, por deri te realizohet plani madhor, a kishte pasur mundësi të intervenohet nëpër rrugë, në ndriçim dhe të zgjidhen problemet me ujin.

Ramiz Durmishi, banor i lagjes, kërkesë që dritaret e shkollës të ndërrohen se janë të vjetra, kjo është emergjente, dhe mbrapa shkollës a mund të bëhet një parking.

Kryetari bëri të ditur se prapa shkollës është në plan të bëhet një park i bukur.

Muhamet Metaj, banor i lagjes, u shpreh se jetojmë në vitin 2022 dhe ende ujë nuk kemi, andaj ju lutem të bëni një zgjidhje për ujin, ndriçimin dhe për rrugët.

Sabedin Gjata, banor i lagjes, tha se shqetësimi im është për faturat që nuk na vijnë në adresë, e po duhet me shkuar në Komune për më e nxjerrë, edhe cila pjese e Kalabrisë është e paraparë për ndërtim individual.

Kryetari theksoi se jemi në proces të Planit, ndërsa sa i përket faturave keni të drejtë, kjo duhet me u digjitalizuar që me i kryer pagesat me telefon, p.sh. që mos me ju krijuar probleme.

Berat Elshani, banor i lagjes, pjesa ku unë jetoj në planin ekzistues është paraparë të bëhet gjelbërim i lartë, atëherë si mendoni me i adresuar këto çështje në planin e ri, kompensimin, dhe në çfarë afati kohor?

Kryetari u shpreh se Arbri veç e cekti me herët, kur tha se çdo pjese që në planin e ri është paraparë gjelbërim, kompensohet me vlerë ndërtimi, ndërsa për afatet kohore nuk mundem tani saktësisht me të dhënë një përgjigje, por do të jeni të informuar.

Muhedin Canolli, banor i lagjes, paraqiti disa ankesa: 1) Ne banorët që jetojmë prej ambulancës e teposhtë nuk kemi kanalizim; 2) Kjo shtëpia përballë këtu është e ndërtuar që sa vite, por nuk jeton askush e në këtë shtëpi sillen të droguar, që është rrezik për ne që jetojmë këtu. E kemi lajmëruar policinë disa herë për këtë; 3) Më herët u fol për rrugën, prej ambulantes e deri te "Kaprolli", është pronë e familjes sime, kjo shkolle është ndërtuar në pronën e familjes sime, të cilën e kanë dhënë falas, unë pa problem e nënshkruaj këtu në prezencën tuaj që e lëvizim rrethojnë e pronës për 2 metra, ma kompensojnë me para edhe gjithçka është në rregull.

Ramos Bekolli pyeti se a ka Komuna ndonjë statistike se sa ndërtime pa leje janë bërë, unë mendoj që kot bëjmë plane përderisa nuk i ndërpresim shkelësit e planeve urbanistike.

Zijadin Hoxha shprehu falënderim për kryetarin dhe stafin e tij, që sot kanë ardhur në vizitë në lagje për t'i parë më afër problemet me të cilat ballafaqohen këta qytetarë.

Taulant Krasniqi pati ankesë për kolektorin dhe ujësjellësin.

Xhevat Mustafa, banor i lagjes, tha se Kalabria ka mbetur lagjja më e varfër dhe në gjendjen më të keqe në qytet, por deri në realizim e planit të madh ju kisha lutur që së paku elementaret të na i ndreqni në lagje, rrugët, trotualet, ujin dhe me afat ju kisha lutur që të implementohet plani, ashtu siç është premtuar.

Naser Krasniqi, banor i lagjes tash e 60 vjet, pronar i pronës afër kolektorit dhe ujësjellësit, ku kemi pasur edhe dëmtime në pronë, sepse është dashtë që në pronën tonë me u bart lumi. Më intereson rruga a ka më qenë si ne planin që është prezantuar, ku 70% e pronës sime atakohet me rrugën, apo ndryshohet, e nëse ndryshohet unë kërkoj që një pjesë të merret edhe nga ana tjetër për rrugë e jo vetëm nga pjesa ime.

Kryetari tha se e ceka edhe më herët që nuk do të dëmtohet askush, ajo çka ju merret ajo ju kompensohet në vlerë të ndërtimit.

Daut Ratkoceri, banor i lagjes, me profesion arkitekt, tha se në ekipin që do ta hartojë planin rregullues, kërkoj që të shqyrtohen pengesat se pse nuk janë realizuar planet e mëhershme, e ne baze të këtyre pengesave të dihet se si do të realizohet plani në të ardhmen, mandej edhe me i marrë parasysh interesat e banorëve.

Driton Begolli, banor i lagjes, kërkoi që përveç kësaj rruge ekzistuese të kemi edhe rrugë të tjera opcionale.

Armend Metaj, banor i lagjes, shprehu mendimin se deri në realizimin e planit, urgjente në lagjen tonë janë rruga, ndriçimi dhe uji.

Kryeatri tha se puna e ndriçimit ka qenë problem i Organit Shqyrtues të Prokurimit, që na kanë ndërpre legalisht, tani jemi në shqyrtim të procesit, shpresoj që të kryhet shpejt.

Masar Dushi, arkitekt, përfaqësues i Asociacionit të Arkitektëve të Kosovës, shprehu falënderim për Kryetarin dhe stafin e tij për këtë debat publik, duke thënë se vetëm kështu me transparencë mund të shkojmë para.

Hafiz Buzuku, banor i lagjes, theksoi se sipas planit në tokën time është paraparë gjelbërim, atëherë si do të ma kompensojnë mua pronën, ku edhe rreth pronës sime krejt është gjelbërim.

Mimoza Sylejmani theksoi se prona juaj kompensohet diku tjetër me vlerë ndërtimi, sipas ligjit, dhe nuk do të dëmtoheni asnjëri nga ju.

Kryetari tha se kur toka private destinohet për ndërtim, në këtë rast e jotja për gjelbërim, bëhet gjelbërim, ndërsa aty ku është e destinuar për ndërtim, koeficienti yt i ndërtimit bëhet pjesë e asaj.

Burim Karaqica tha se ne e kemi një problem që na kanë bërë bashkëpronar në pronë, jemi 46 bashkëpronarë dhe unë nuk mundem me marrë asnjë vendim për pronën time, pa qenë edhe ata prezentë, a është ky problem i Komunës apo Gjykatës.

Arbër Sadiki, bëri të ditur se janë disa parcela në Prishtinë që e kanë të njëjtin problem, kadastrin nuk qet kufij të ri pa pëlqimin e të gjithë bashkëpronarëve, nëse vetëm njëri nuk është i pëlqimit, atëherë rasti shkon përmes gjykatës.

Muhamet Metaj tha se një pjesë e rrugës “Asllan Poka” është e bllokuar ilegalisht, a ka mundësi dikush me dalë në teren me e pa, e kam thirrur disa herë inspeksionin, edhe policinë por ende asgjë.

Sefedin Ahmeti, pronar toke në lagje, probleme ka shumë, por po shpresoj që me planin e ri do të zgjidhen, këtu për shembull në raste emergjente nuk mund të intervenohet, për shkak të rrugës që janë në gjendje të mjerueshme, plus që janë të bllokuara nga automjetet.

Minush Krasniqi pyeti se pjesa e kolektorit të “Gardenit” a është në projekt me rrugën “A” apo në kuadër të unazës.

Kryetari tha se ajo pjesë e lagjes është në projekt me rrugën “A”.

Basri Ternava kërkoi që premtimet e dhëna të mbahen dhe të përmbushen edhe deri tani i dëgjuam të gjitha ankesat dhe kërkesat nga banorët e lagjes, probleme që ekzistojnë. Duam ta dimë se deri ku keni mbërri me Planin rregullues dhe me çfarë mund të ju ndihmojmë ne si qytetarë.

Kryetari theksoi se jemi në proces të punës, deri tani kjo është analiza që kemi bërë, që plani ekzistues nuk i përmbush nevojat për koeficient 2.4, një plan rregullues i mirëfillt bëhet me analiza, mbledhjen informata, diskutime, merren parasysh nevojat e qytetarëve dhe fillojmë me intervenime infrastrukturore, e jo me ndodh si ne disa lagje të Prishtinës që është ndërtuar ndërtesa e mandej është intervenuar në kanalizim. E thash edhe më herët, këtë po mundohemi me e shmangur këtu, që të nisët për së mbari.

Sebihate Ajetaj, banore e lagjes, pyeti se me zgjerimin e Prishtinës, ne si Kalabria në cilën zonë jemi, jemi me qendër apo me periferi.

Kryetari bëri të ditur se plani i kryeqytetit është duke u bërë, këtu duke e përfshirë edhe lagjen “Kalabria”, ku çdo zonë me e pasur mundësitë që çdo gjë që i nevojitet një qytetari me e pasur brenda zonës ku ai jeton: shkolla, qendra mjekësore, parqe, hapësira rekreative, qendra ditore për të moshuar për socializim, të gjitha këto janë pjesë e zhvillimit të një shoqërie. Gjerat e mira duhet të planifikohen me fillim.

Ju faleminderit shumë për pjesëmarrje!

Shihemi në diskutimet e radhës.

Më, 22.05.2022



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina



Lista e pjesëmarrësve

Tema: Problematikat e lagjes

Datë: 22.05.2022

Nr.	Emri dhe Mbiemri	Nnëshkrimi
1	Detan Perovica	
2	Gjergj Perovica	
3	Ali Svirca	
4	FATON NEZIRI	
5	Xhevat Muntaku	
6	DIANA HAXHA BERISHA	
7	Sami Berisha	
8	Klaser Kromiqi	
9	HYRJETE LUKAJ	
10	SADETE LUKAJ	
11	Njazi Krosnigji	
12	BITSHKIM MALOKU	
13	ISMAIL REUKOVI	
14	SHYQRI DUKANI	
15	Voshtin Kromiqi	
16	KLASER GASHI	
17	Salat Dobërdoli	
18	BAJRAM GASHI	
19	Gjergj Muntaku	
20	Deris Dendi	
21	Bashir Haxhiu	
22	Asim Bajama	
23	Edi Ahmet	
24	BURIM HASAN	
25	Eqzon Dervishaj	
26	Alban Dervishaj	
27	Asim Shasani	
28	ISUE Salihu	
29	REHMET GOCALI	
30	MEHMET COKAJ	
31	Shafi Haxha	
32	Adnan Pacoli	
33	Adit Gërbesliu	
34	Kujtim Bajama Gërbesliu	
35	Flori Tazari	
36	Kemo Krosnigji	



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina

Lista e pjesëmarrësve

Tema: Problematikat e lagjes
Datë: 22.05.2022

Nr.	Emri dhe Mbiemri	Nnëshkrimi
1	GRANT PRESTRECH	
2	SOVRAN OLLUPI	
3	PLEHA Syle	
4	ARSEN BASHIRI	
5	ZYMER VELIU	
6	MINUSH KRASHI	
7	MASOR ITISHI	
8	Ragip Dohërdazi	
9	BLEKIM MUSKU	
10	Sadedin Doda	
11	Agon Krasniqi	
12	WILSON KRASHI	
13	Hidem Krasniqi	
14	ESKUR SUTCU	
15	DRITON BASHIRI	
16	MURAT KASIM	
17	BURIM KARAGIJA	
18	ILU BIZINISI	
19	RAMET KASIM	
20	BESIAN HOVA	
21	FATMIR SYLLETHAN	
22	ADEM ZEKA	
23	Muharrem HONDA	
24	LUMI PRUSTOLLI	
25	B. BOJAN	
26	ARMEND METAJ	
27	LAJLANT KRASHI	
28	KINOR MURATI	
29	KASTRIOT GASHI	
30	BASRI TENKAVA	
31		
32		
33		
34		
35		



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina



Lista e pjesëmarrësve

Tema: Problematikat e lagjes

Datë: 22.05.2022

Nr.	Emri dhe Mbiemri	Nnëshkrimi
1	Ardayc Idrish Kozdrami	
2	Mujedin Camdli H	
3	NAZIF XLINOVCI	
4	ELSHADAT DEXHEDI	
5	MUDAMET METAJ	
6	ARLANIT METAJ	
7	BUDAR STATOVCI	
8	KUSHTRIH ZHIGECI	K
9	HILMI CAMDOLI	
10	FRIDON ELLEN	
11	ARCEJEND KOSTRATI	
12	SHKURTI HAKU	
13	XHEVAT VLAZI	
14	BESNIK HATI	
15	FRIDON SPATKON	
16	PORTULLA PUPEROVI	
17	REIS HAKULLI	
18	FERIZ JASHANICA	
19	ENRICA OSMANI	
20	ALBERT JASHANICA	
21	ARSIJA QITAKU	
22	DREN TIGANI	O
23	BUDAR TIGANI	
24	FLORIM MUSTAFIA	
25	ARBEN JEQIRI	
26	ILIJADIN JEQIRI	
27	BESIM JASHARI	
28	APRAN DUPALI	
29	ARMEND METAJ	
30	ALBAN SITKODRA	
31	MUSLI BUDRAM	
32	AMIR MEHMETI	
33	ADRIAN MEHMETI	
34	ARMAN KURMANI	
35	GEORGI HAKU	



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

Lista e pjesëmarrësve

Tema: Problematikat e lagjes

Datë: 22.05.2022

Nr.	Emri dhe Mbiemri	Nnëshkrimi
1	Liridon MASHKUR	
2	VALON ZEKA	
3	FERIZ ZEKA	
4	CHETI ZEKA	
5	LIRIDON SHKORRRI	
6	PLUMBA DASH	
7	BASHM KRASHIÇI	
8	WALIM LASHIÇI	
9	ALBERT FAZLI	
10	RAME KRASHIÇI	
11	FAZIL HODOZI	
12	DRILON DUGOLLI	
13	HARVEK KRASHIÇI	
14	DIRLIND KASHIÇI	
15	SADRI SODRI	
16	SHYMETE KASHIÇI	
17	SHYMETE KASHIÇI	
18	USAT HALITI	
19	FATMIR DERRI	
20	RAMI SODRI	
21	LEART IBRAHIMI	
22	IRAZ SODRI	
23	ECINUR KASHIÇI	
24	RESNIT THUGI	
25	KORAB JANSEVA	
26	NYKHAT KRASHIÇI	
27	ILIR IBRAHIMI	
28	XHEVAT KRASHIÇI	
29	SHPLESA IHERA	
30	KADIE WUDILI	
31	SAM NASHI	
32		
33	NASER KRASHIÇI	
34	BEKIM MORINA	
35	ILIR ZEGIRI	